

HULUMTIM MBI LAPIDARËT E SHQIPËRISË¹

VINCENT W.J. VAN GERVEN OEI

Abstrakt

Gjatë diktaturës komuniste, regjimi shqiptar ngriti një numër të konsiderueshëm lapidarësh në pothuajse çdo fshat, qytezë dhe qytet të vendit. Këto monolite prej betoni funksiononin si monumente që përkujtonin një sërë “dëshmorësh të kombit” rënë gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare (1944-5), dhe në të njëjtën kohë monumentalizonin prezencën e Partisë së Punës së Shqipërisë anembanë vendit. Funksioni i tyre si shënjues të kujtesës dhe njëkohësisht të progresit të shoqërisë komuniste shfaqet qartazi në “poemën kinematografike” të Viktor Gjijkës, *Lapidari* (1984). Përhapja masive e këtyre strukturave monumentale krahas kontrastit të tyre me peizazhin aktual urban – as të shembura dhe as të mirëmbajtura, por thjesht të lëna në mëshirë të fatit – i bën

¹ Përkthyer nga anglishtja nga Jonida Gashi.

ato struktura emblematike të së kaluarës komuniste të Shqipërisë, e cila vazhdon të mbetet e pabluar.

Në vitin 2014, zyra për hulumtime në arte dhe humanitete, Departamenti i Shqiponjave (The Department of Eagles) nisi projektin kërkimor “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, me qëllim kryerjen e kërkimeve mbi ndërtimin dhe topografinë e lapidarëve në tërësi dhe kontekstit të tyre historik në Shqipëri, krahas dokumentimit dhe gjeotiketimit elektronik (*geotagging*) të të gjithë lapidarëve që kanë mbetur në Shqipëri dhe që mund të identifikoheshin nëpërmjet burimeve arkivore ose intervistave. Në kundërshtim me projekte të ndryshme artistike që ishin zhvilluar ndërkaq në vende të tjera postkomuniste, si në ish-Jugosllavi apo Bullgari, të cilat i qaseshin formave monumentale të së shkuarës me një sy estetik, për të mos thënë që i ngrinin ato në qiell, qëllimi i projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë” ishte njëherazi i një natyre gjenerike dhe enciklopedike, konkretisht që t’i bënte këto artefakte kulturore të aksesueshme për hulumtuesit në të ardhmen, nëpërmjet publikimit të një databaze në linjë si dhe një katalogu me akses të hapur (*open access*).

Rezultatet përfundimtare të projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, u botuan në vitin 2015 në një vepër tre-vëllimshe, nga shtëpia botuese punctum books.

Fjalë kyçe: lapidar, komunizëm, postkomunizëm, monument, propagandë, dokumentim digjital, botim me akses të hapur, Departamenti i Shqiponjave, punctum books

Gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri, regjimi ngriti një numër të madh lapidarësh në pothuajse çdo fshat, qytezë dhe qytet të vendit. Këto monolite prej betoni funksionin kryesisht si

monumente që përkujtonin lloj-lloj “dëshmorësh të kombit” rënë gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare (1944-1945) dhe ishin pjesë e përpjekjes për të krijuar një zhanër të ri shenjtorësh politikë, me qëllim zëvendësimin e shenjtorëve fetarë që regjimi ateist i kishte ndaluar. Pjesë e këtij projekti ishin dhe hagiografitë e sanksionuara nga shteti,² një rrjet me “varreza të dëshmorëve” në çdo qark të vendit që funksiononin si site ritualiste,³ si dhe riemërtimi i rrugëve dhe institucioneve publike në çdo cep të vendit. Kulti i këtyre shenjtorëve ushtarakë dhe ngritja e lapidarëve kishin edhe një tjetër funksion, konkretisht skalitjen dhe monumentalizimin e prezencës së Partisë së Punës së Shqipërisë si në peizazhin ashtu dhe në shoqërinë shqiptare. Me kalimin e kohës lapidarët u përdorën për të përkujtuar arritjet e vetë komunizmit, si për shembull reformën agrare apo ndërtimin e rrugëve të caktuara, arritje të cilave iu kushtuan monumente të posaçme. Sot, këto struktura monumentale që as janë shembur dhe as janë ruajtur por thjesht janë lënë të degradohen, që janë të kudondodhura por që njëkohësisht kërcasin me peizazhin urban bashkëkohor, përfaqësojnë një emblemë të së kaluarës komuniste, ende të pabluar, të Shqipërisë.

Ideja për projektin “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë” më lindi pikërisht si një reagim ndaj faktit se pavarësisht se lapidarët janë mjaft të përhapur në peizazhin kulturor shqiptar, nuk ekzistonte ndonjë katalog apo databazë e përditësuar e këtyre monumenteve. Jo vetëm kaq, lapidarët duket se ishin të destinuar t’i nënshtroheshin një procesi të *damnatio memoriae* (“mallkimi i

² *Yje të pashuar*, 5 vëll., Drejtoria politike e ushtrisë popullore të R.P.Sh.,1971–.

³ Shih: Gëzim Qëndro, “Tanatologjia e shpresës”, në *Lapidari*, red. Vincent W.J. van Gerven Oei, punctum books, 2015, 1:67–72.

kujtesës”), aq sa të kujtonin ish-udhëheqësit komunistë që pasi binin nga pushteti, emrat e tyre zhdukeshin nga librat e kohës.⁴ Në të njëjtën kohë, në vende të tjera të Ballkanit dhe ish-Bllokut të Lindjes, interesi si artistik ashtu dhe akademik rreth këtyre monumenteve, dhe arkitekturës së periudhës komuniste në përgjithësi, sa vinte e rritej, ku nuk mungonin as projektet tërheqëse fotografike.⁵ Edhe në rastin e Shqipërisë, ekzistonte një pjesë e trashëgimisë arkitekturore të komunizmit, të ashtu-quajturat “kërpudha prej betoni” ose bunkerët, që po tërhiqte vëmendjen e gjithmonë e më shumë artistëve dhe fotografëve.⁶ Nga ana tjetër, asnjë prej këtyre projekteve nuk kishte një karakter sistematik apo enciklopedik. Përkundrazi, këto projekte kishin tendencën të përqëndroheshin tek monumentet dhe ndërtesat komuniste më fotozhenike, duke lënë në hije (të padokumentuara)

⁴ Shih: Vincent W.J. van Gerven Oei, “The Production of Hronir: Albanian Socialist Realism and After”, në *Workers Leaving the Studio. Looking Away from Socialist Realism*, punctum books, 2015, ff. 191–207.

⁵ Shih, për shembull, Nikola Mihov, “Forget Your Past”, 2009–12, <https://www.nikolamihov.com/forget-your-past>; Roman Bezjak, *Socialist Modernism*, Hatje Cantz, 2011; Frédéric Chaubin, *Cosmic Communist Constructions Photographed*, Taschen, 2011; Robert Burghardt and Gal Kirn, “Yugoslavian Partisan Memorials: Hybrid Memorial Architecture and Objects of Revolutionary Aesthetics”, *Manifesta Journal*, nr. 16, 2012, ff. 84–91; Jan Kempnaers, *Spomenik*, Roma, 2015; dhe, kohët e fundit, Donald Niebyl, *Spomenik Monument Database*, FUEL, 2018, with the website <https://www.spomenikdatabase.org/>. Shih gjithashtu projektin e dokumentimit në linjë *Totally Lost*, <https://www.totallylost.eu/>.

⁶ Alicja Dobruska, “Concrete Mushrooms”, 2011, <https://www.alicjadobruska.com/Concrete-Mushrooms>; Elian Stefa, Gyler Mydytidhe Niku Alex Muçaj, *Concrete Mushrooms: Reusing Albania's 750,000 Abandoned Bunkers* (dpr-barcelona, 2012); David Galjaard, *Concresco*, vetëbotuar, 2012, dhe recensionin nga Ardian Vehbiu, “Bunkerit Shet”, *Peizazhe të Fjalës*, 12 mars 2013, <https://peizazhe.com/2013/03/12/bunkerit-shet/>.

shumë e shumë monumente dhe ndërtesa të tjera, “më të zakonshme” le të themi. Kjo qasje romantike ndaj subjektit në fjalë reflektohej dhe në stilin e fotografimit që përdorej për t’i dokumentuar këto monumente, ku spikasnin këndet dramatike dhe paletat e ngjyrave që kishin për qëllim ta ekzotizonin këtë lloj arkitekture. Mua më interesonte pikërisht e kundërta: fakti që këto monumente ishin të kudondodhura dhe monotone, krejt normale dhe madje të mërzitshme. Më tërhiqte më shumë qasja konceptuale e Bernd dhe Hila Becher se sa patina vezulluese e fotografisë proto-propagandistike.

Kështu, në vitin 2014, zyra për hulumtime në fushën e arteve dhe humaniteteve, Departamenti i Shqiponjave (The Department of Eagles) nisi projektin “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”. Projekti përfshinte hulumtime mbi ndërtimin, topografinë dhe kontekstin historik të lapidarëve në tërësi, si dhe dokumentimin dhe gjeoetikimin elektronik (*geotagging*) të lapidarëve të mbetur në Shqipëri.⁷ Metodologjia e përdorur gjatë këtij projekti ndahej në tri faza: punë kërkimore, punë në terren, dhe botim. Faza kërkimore kishte për synim mbledhjen e çdo lloj informacioni të mundshëm rreth lapidarëve shqiptarë dhe vendndodhjes së tyre. Për ta arritur këtë, u shqyrtuan imtësisht edhe koleksionet e imazheve të gjeoetiketuara në linjë dhe në rrjetet sociale, si për shembull në platformat Flickr, Panoramio, Facebook dhe Wikimapia, krahas rishikimit të letërsisë dhe filmave prodhuar gjatë diktaturës që preknin temën e dëshmorëve të kombit. Veç kësaj, unë zhvillova, gjithashtu, intervista me një sërë skulptorësh, arkitektësh, juristësh, dhe ish-politikanësh të cilët kishin qenë aktivë gjatë diktaturës, për të kuptuar proceset artistike

⁷ Department of Eagles, “Albanian Lapidar Survey”, <http://departmentofeagles.org/als/>.

dhe burokratike pas planifikimit, dizenjimit dhe krijimit të lapidarëve. Kuptohet që edhe kërkimi në arkiva, si Arkivi i Shtetit, Arkivi i RTSH-së, dhe Instituti i Monumenteve, mori kohën e tij. Nëpër këto arkiva unë u përpoqa të mbledh të gjithë dokumentet zyrtare (ato që kishin mbetur të paktën) dhe materialet e tjera dokumentuese mbi planifikimin, ndërtimin dhe inaugurimin e lapidarëve. Të dhënat gjeografike dhe fotografike u organizuan në një databazë përmes së cilës ndërtova një hartë në Google Map me vendndodhjet e të gjithë lapidarëve, ndërkohë që materiali fotografik u nda me publikun në platformën Tumblr.⁸

Ishte e habitshme, në fakt, se sa pak materiale arkivore ekzistonin rreth këtyre elementëve arkitekturorë kaq të përhapur në peizazhin shqiptar. Mendoj se kjo situatë mund të shpjegohet nëpërmjet dy faktorëve. I pari lidhet me faktin se në pjesën dërrmuese të rasteve planifikimi dhe zbatimi i projekteve mbi ndërtimin e lapidarëve ishte një proces që zhvillohej në nivel qarku. Kjo nënkupton se në pjesën dërrmuese të rasteve përgjegjësia për lapidarët binte mbi pushtetin vendor dhe jo atë qendror, i cili përfshihej vetëm në projektet monumentale madhore. Rrjedhimisht, pjesa dërrmuese e materialeve arkivore rreth lapidarëve duhet të ketë qenë e depozituar në arkivat rajonale, të cilat për shkak të riorganizimeve territoriale të njëpasnjëshme gjatë epokës post-diktatoriale, si dhe të gjendjes së mjerueshme të arkivave rajonale në përgjithësi, ishin thuajse të parikuperueshme. Bënte përjashtim Muzeu Historik i Çorovodës, ku gjetëm një broshurë të viteve 1980, në të cilën listoheshin të gjithë monumentet kryesore që ndodheshin në rrethin e Skraparit,

⁸ Department of Eagles, “Albanian Lapidar Survey”, <http://departmentofeagles.org/als/>.

e vetmja dëshmi e mbikëqyrjes dhe mirëmbajtjes së lapidarëve në rang rajonal. Faktori i dytë ka të bëjë me faktin se lapidarët ende nuk njihen si trashëgimi kulturore, çka shpjegon mungesën e ekspertizës mbi ta në Institutin e Monumenteve, dhe mungesën e të dhënave në Arkivin e Shtetit.

Faza e dytë e projektit ishte puna në terren e cila kishte për qëllim dokumentimin e të gjithë lapidarëve ekzistues (të mbetur) në Shqipëri. Gjatë fazës kërkimore kishim identifikuar rreth 500 vendnoddhe (të mundshme) lapidarësh, dhe mbi bazën e këtyre të dhënave planifikuam rreth 60 ditë punë në terren, duke përllogaritur se do të dokumentonim mesatarisht 10 lapidarë në ditë. Çdo lapidar u dokumentua nëpërmjet plotësimit të një formulari të thjeshtë ku u shënuan të dhënat bazike rreth lapidarit, si dhe nëpërmjet akordimit të një numri identifikimi unik dhe një etikete elektronike me të dhënat gjeohapësinore (*geotag*). Të gjithë lapidarët u dokumentuan në mënyrë identike dhe sistematike me një aparat Nikon Df me lente *tilt/shift*, ndërsa udhëtimi nëpër Shqipëri u dokumentua nëpërmjet një aparati fotografik automatik të tipit Narrative Clip i cili u montua në makinë, një kameraje digjitale të tipit Flip Video, si dhe një aparati fotografik rezervë. Ecuria e punës në terren u dokumentua në linjë nëpërmjet postimit të imazheve fotografike në platformën Tumblr, dhe të videoklipeve në platformën Vimeo.⁹ Si përfundim, puna në terren u realizua brenda 50 ditësh, ku ekipi ynë përshkroi 7,500 km, dhe numri i lapidarëve të dokumentuar arriti në 657.

Gjatë fazës së tretë u përqendruam tek organizmi dhe klasifikimi i të dhënave dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë

⁹ “Department of Eagles”, Vimeo, <https://vimeo.com/departmentofoeagles>.

punës në terren, të cilat u botuan në një vepër tre-vëllimëshe nga shtëpia botuese me akses të hapur (*open-access*) punctum books.¹⁰

Në kundërshtim me disa monumente të vendeve ish-Jugosllave, të cilat falë modernizmit të tyre ekstravagant të duket sikur arrijnë të rrokin lëvizjen e kohës, lapidarët e Shqipërisë janë monumente *në kohë*. Teksa objektet/subjektet që ata përkujtojnë ishin statikë/të pandryshueshëm, forma e tyre kishte për qëllim të përcillte progresin e shtetit komunist. Që do të thotë se lapidarët shembeshin rregullisht për t'u rindërtuar më pas me materialet dhe teknikat më të fundit, duke bërë që akti i përkujtimit të imitonte dhe të pasqyronte progresin komunist. Ky parim thelbësor i monumentalitetit komunist shqiptar shprehet më qartë se kudo tjetër në “poemën kinematografike” *Lapidari* (1986), me regji të Esat Ibros dhe skenar të Viktor Gjikës.¹¹

Lapidari ndjek “jetën” e një lapidari, duke filluar me lindjen e tij si varri i thjeshtë i një partizani rënë gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Teknologjia është më bazikja e mundshme, një pirg dheu i mbuluar me gurë të mëdhenj, dhe një gur i madh i rrumbullakët tek koka, ku një partizan gdhend me thikën e tij një yll rundimentar me 5 cepa. Pas kësaj vjen paqja, dhe ne shohim një çoban duke punuar me daltë mbi një pllakë, shqiponjën me dy koka të Skënderbeut. Teksa vejusha e partizanit dhe nëna e tij kujdesen për varrin, në sfond dëgjojmë zërin e një foshnjeje që qan. Lind djali i partizanit. Lapidari vëzhgon nga larg se si familja *queer* e përbërë nga nëna, grua dhe djali i partizanit bëhen zotër të tokës ku jetojnë. Nga këndi i kundërt shohim transferimin e

¹⁰ Vincent W.J. van Gerven Oei, red., *Lapidari*, 3 vëll., punctum books, 2015.

¹¹ Shih dhe: Roland Bejko, “Rreth filmit *Lapidari*”, në *Lapidari*, red. Vincent W.J. van Gerven Oei, punctum books, 2015, 1:129–32.

pronësisë nga këndvështrimi i varrit. Pastaj shohim kultivimin e tokës përreth lapidarit, dhe fshatarët që sëbashku mbledhin gurë për përditësimin e parë që i bëhet monumentit, ngritja e një lapidari të mirëfilltë prej guri të prerë, me një yll të kuq me shqiponjën me dy koka. Në sfond dëgjohet fishkëllima e një treni, i cili sinjalizon një tjetër avancim teknologjik. Një natë dimri me dëborë, lapidari vëzhgon teksa brigadat vullentare kapin armiq të që hidhen me parashutë brenda territorit të vendit. Makinat dhe kamionat sinjalizojnë avancimin teknologjik të rradhës, dhe lapidari ndriçohet nga shkëndijat që lëshon saldimi i metaleve. Një altoparlant shpall ndarjen nga Bashkimi Sovjetik. Djali i partizanit është rritur dhe, nën syrin vrojtues të lapidarit, merr pjesë në stërvitje ushtarake si dhe manovron makineri të rënda bujqësore. Industrializimi i sektorit minerar mundëson një tjetër përditësim të monumentit, i cili shndërrohet në një lapidar të madh të veshur me mermer. Djali i partizanit martohet. Dhjetra fëmijë të veshur me të bardha, mes tyre padyshim dhe nipërit e mbesat e partizanit, festojnë rreth lapidarit nën drejtimin e mamasë së djalit, tanimë një grua plakë. Kamera tërhiqet. Buçet muzikë fitimtare. Fund.

Ajo çka del në pah tek *Lapidari* i Gjikës dhe Ibros, është fakti se lapidari shqiptar shkon përtej përkujtimit të heronjve të Luftës Nacional-Çlirimtare; përveçse çimentojnë figurën e partizanit si origjina e legjitimitetit politik të Partisë së Punës së Shqipërisë, lapidarët shërbejnë njëkohësisht si një pasqyrë e përhershme e arritjeve të kësaj të fundit. Lapidari “vëzhgon” teksa partia përmush detyrat e saj ndaj popullit, nëpërmjet kolektivizimit të tokës, industrializimit të agrikulturës e kështu me rradhë. Për shkak të funksionit të dyfishtë të lapidarëve në rrafshin përfaqësues, u zhvillua dhe tendenca për ngritjen e lapidarëve gjithnjë e më të lart, kjo pasi monumenti nuk simbolizonte thjesht

sakrificën e partizanëve por edhe prestigjin e Partisë. Kjo pohohet në mënyrë eksplicite në një artikull të shkruar nga Kujtim Buza dhe Kleanthi Dedi në *Zërin e Popullit* në vitin 1971, ku autorët ankohen se:

“Ngritje pa kriter, sa më lart, e lapidarëve, shkëputja nga toka lart në qiell, të qënurit pa tjetër një lapidar e një kollone që ngrihet përpjetë. – kjo u tepërua dhe u bë kriter negative në këto realizme.”¹²

Fakti se një nocion i ngjashëm mbi monumentalitetin vazhdon të mbizotërojë në peizazhin kulturor të Shqipërisë bashkëkohore është tejet domethënës; një simptomë e faktit se e kaluara diktatoriale e vendit mbetet e pabluar. Masterplani i parë arkitekturor i Tiranës, i cili u zhvillua nën udhëheqjen e Edi Ramës – djali i skulptorit më të rëndësishëm të realizmit socialist – në kohën kur ai ishte kryebashkiak i Tiranës, parashikonte ndërtimin e 10 qiellgërvishtësve përreth qendrës së qytetit.¹³ Zbatimi i këtij plani, i cili nuk ka asnjë lidhje me nevojat urbane reale të Tiranës, ka dominuar vizionin e Ramës mbi qytetin derisa ai u bë Kryeministër. Një shembull i dytë i fiksimit, të trashëguar, të Ramës me një formë vertikale monumentaliteti, ishte reagimi i tij ndaj shkatërrimit të skulpturës së Carsten Höller në oborrin e

¹² Kujtim Buza dhe Kleanth Dedi, “Simbole dinjitoze ngjarjeve historike”, në *Lapidari*, red. Vincent W.J. van Gerven Oei, punctum books, 2015, 1:49–51.

¹³ “51N4E Reveals 'French Plan' for Skënderbeg Square – Exit Explains”, *Exit*, 12 qershor 2017, <https://exit.al/en/2017/06/12/51n4e-reveals-french-plan-for-skenderbeg-square/>.

Kryeministrisë, *Giant Triple Mushroom* (2015),¹⁴ konkretisht rindërtimi i një versioni akoma më të madh të kësaj të fundit.¹⁵

Kështu, “ngritja pa karar” e qiellgërvishtësve dhe monumenteve si simbole të pushtetit të regjimit të Ramës, është një vazhdimësi e traditës së lapidarëve e cila u shtjellua për herë të parë gjatë diktaturës, çka tregon vazhdimësinë e theksuar midis politikave kulturore të para- dhe pas-viteve 1990 në Shqipëri. Rrjedhimisht, vijimi i hulumtimeve mbi këto monumente është thelbësor, për të kuptuar situatën në të cilën gjendet vendi, sepse në fund të fundit, TID Tower nuk është asgjë më shumë se sa një përditësim teknologjik i monumetit në filmin *Lapidari*, “shkëputur nga toka lart në qiell”.

¹⁴ Vincent W.J. van Gerven Oei, “Comment: The Mushroom at the End of the Regime”, *Exit*, 17 shkurt 2019, <https://exit.al/en/2020/07/27/the-mushroom-at-the-end-of-the-regime-2/>.

¹⁵ Alice Taylor, “Replacement Mushroom Outside Edi Rama's Office in Tirana”, *Exit*, 25 korrik 2020, <https://exit.al/en/2020/07/25/replacement-mushroom-erected-outside-edi-ramas-office-in-tirana/>.



Fig. 1. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.



Fig. 2. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.



Fig. 3. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.



Fig. 4. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.



Fig. 5. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.



Fig. 6. Dokumentim i punës në terren në kuadrin e projektit “Hulumtim mbi lapidarët e Shqipërisë”, 2014. Fotografuar nga Xheni Alushi. Riprodhuar me lejen e Departamentit të Shqiponjave.